

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5834
E martë, 23 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Fillon aplikimi për kompensimin e mësimit të viteve të '90-ta



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI LAJÇI | FAQE 4 - 5

Gjendja në Kosovë mund të ndryshojë nëse kryeministri vjen nga Vetëvendosja

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka bërë me dije se janë për bashkëpunim me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) por, sipas tij, ndryshimet në vend mund të vijnë vetëm nëse Lëvizja Vetëvendosje udhëheq postin e kryeministrit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Lajçi ka theksuar se gjasat janë që Lëvizja Vetëvendosje të dalë partia e parë dhe ta ketë postin e kryeministrit. Ai ka pohuar se mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme nuk duhet të shtyhet më shumë se në muajin shtator



Njohësit kushtetues dhe zgjedhorë: Kompletimi i KQZ-së, çështje urgjente

Njohësit e çështjeve kushtetuese dhe zgjedhore, Mazllum Baraliu dhe Blerim Burjani, kanë vlerësuar se pas zhvillimeve të fundit në skenën politike kompletimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është çështje urgjente. Ata i kanë bërë thirrje Gjykatës Kushtetuese që me prioritet ta shqyrtojë ankesën e subjekteve politike lidhur me ligjshmërinë e vendimit të presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së muaj më parë. Sipas tyre, në bazë të këtij vendimi presidenti duhet t'i emërojë edhe dy anëtarë të rinj të KQZ-së nga radhët e koalicionit PAN



Në Prishtinë vihet gurthemeli i bustit të senatorit Bob Dole



AKTUALE



VENDIMI I GJND-së, FITORJA MË E MADHE NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS F. 2

HARADINAJ E DORËZON NË KUVEND LETRËN E DORËHEQJES, KËRKON ZGJEDHJE TË REJA F. 3

VESELI KËRKON NGA KRYETARËT E DEGËVE FORMIMIN E SHTABEVE ZGJEDHORE F. 7

EKONOMI

RUKIQI: SITUATA POLITIK DO TË NDIKOJË NË KLIMËN E BIZNESIT F. 9

SHALA NËNSHKRUAN VENDIMIN PËR NDËRTIMIN E INKUBATORIT TË BIZNESEVE NË SKENDERAJ F. 8

KULTURË

135 TITUJ LIBRASH TË BLERË DHE TË PËRKRAHUR NGA MKRS-JA I DHUROHEN FSK-së F. 9



SPORT

PENSIONOHET REKORDMENI FITIM HALITI F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Nëntë vjet më parë GjND rrëzoi Serbinë për Kosovën

TIRANË, 22 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta përmes një statusi në rrjet përkujton vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila njohu aktin e shpalljes së pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës.

Vendimi historik, sipas presidentit ishte njëkohësisht vlerësim për sakrificat e atyre që luftuan e nuk bënë asnjë kompromis në kurriz

të Kosovës.

Atëherë në postin e ministrit të Jashtëm, Meta thotë se ka punuar fort për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës, si shtet i lirë dhe i pavarur

"Nëntë vjet më parë, pretendimit serb mbi paligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i dha fundin e merituar, duke njohur aktin e shpalljes

së pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

Ky vendim historik ishte njëkohësisht njohje dhe vlerësim ndaj sakrificave sublime të të gjithë atyre që nuk iu nënshtuan spastrimit etnik dhe nuk bënë asnjë kompromis me të drejtën e patjetërsueshme të qytetarëve të Kosovës, për të jetuar të lirë dhe në paqe si të gjithë evropianët e

tjerë.

Ishte kënaqësi për mua ta përjetoj këtë moment historik si ministër i Jashtëm, asokohe i një qeverie që bëri më të mirën për të forcuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës

Kosova si shtet i lirë dhe i pavarur është realitet i pakthyesëm që ka kontribuar për më shumë paqe, siguri dhe stabilitet në rajonin tonë", ka shkruar Meta.



Vendimi i GjND-së, fitorja më e madhe ndërkombëtare e Kosovës

Në nëntëvjetorin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se kjo ishte fitorja më e madhe ndërkombëtare e Republikës së Kosovës e cila i hapi rrugë forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar dhe vulosi përjetësisht të drejtën tonë për vetëvendosje



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Të hënën janë bërë nëntë vjet nga vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), e cila konfirmoi të drejtën tonë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Me këtë rast, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se kjo ishte fitorja më e madhe ndërkombëtare e Republikës së Kosovës e cila i hapi rrugë forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar dhe vulosi përjetësisht të drejtën tonë për vetëvendosje. "Ky vendim ka trasuar rrugën për anëtarësimin e Kosovës në NATO, BE dhe OKB", ka thënë Thaçi.

Edhe kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka thënë se një nga datat më të rëndësishme të shtetësisë së Kosovës është edhe 22 korriku i vitit 2010, kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

shpalli verdiktin se pavarësia e Kosovës është legjitime dhe e drejtë dhe nuk bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare. "Ky vendim historik për vendin konfirmoi themelet e pavarësisë sonë, të sovranitetit të shtetit dhe integritetit territorial. Për koincidence, një ditë para vendimit të GjND-së, më 21 korrik, unë u thirra në Hagë, në procesin e dytë gjyqësor. Sot, kur sërish thirrem në Hagë, në këtë përvjetor të nëntë, Kosova është më e fortë se kurrë, si shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm dhe i përkushtuar në rrugën euroatlantike", ka thënë Haradinaj.

Po ashtu, edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se vendimi i 22 korrikut të vitit 2010 mbetet ndër sukseset më të mëdha të Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke i vulosur kështu përpjekjet dhe aspiratat tona shekullore për Republikën e Kosovës. "Vendimi i GjND-së

ishte goditja më e madhe për kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës dhe i hapi rrugë Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare", ka deklaruar Limaj.

Ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) ka vërtetuar se pavarësia e Kosovës dhe kufijtë e saj janë legjale dhe legjitime.

Ajo ka thënë se vendimi i GjND-së ishte fitore historike për Kosovën, e cila ka mposhtur Serbinë në planin ndërkombëtar. "Një fitore tjetër ishte vendosja e kufirit ndërkombëtar mes Kosovës dhe Serbisë në dialogun e Brukselit në vitin 2011. I dhamë vulën kombëtare dhe ndërkombëtare shtetit tonë, Kosovës, pas 100 vjetësh luftë dhe sakrificave biblike të shqip-

tarëve. Pas gjithë këtyre fitoreve kolosale, si guxuan disa zëra të flasin për prekjën e kufijve të Kosovës? A nuk e menduan se këta kufij dhe ky shtet janë të shenjtë për neve dhe i mbrojmë çdoherë me të gjitha mjetet. Ne jo vetëm mposhtëm këto ide të rrezikshme që u shfaqën kohën e fundit, por do t'i mposhtim çdoherë dhe në çdo rrethanë", ka thënë Tahiri.

Gjendet i vrarë presidenti i vetëshpallur i Çamërisë

PRISHTINË, 21 KORRIK - Miq dhe bashkëkombës të shumë shpërndanë mesazhe në rrjetet sociale, duke thënë se në Holandë është vrarë në një atentat Festim Lato. Disa orë pas reagimeve, mediet holandeze shkruajnë se Lato dyshohet se është personi që është gjetur të dielën i vrarë në Holandë.

Mediet e Holandës shkruajnë se të

dielën në mëngjes është gjetur i vrarë në Nijmegen shtetasi Festim Lato. Shqiptari kishte borxhe të shumta dhe kjo mendohet se është edhe arsyeja e vrasjes apo vetëvrasjes së tij. Policia tha më herët se kishte marrë një njoftim. Familjarët e tij kishin thënë se i afërmi nuk po bëhej i gjallë që një javë.

Trupi i tij i pajetë është gjetur në një

rrugë në Nijmegen të shtunën pasdite. Policia ende po e heton rastin. Në vitet e fundit, Lato ka qëndruar në një shtëpi të largët në Afferden, në Betuwe. Në këtë shtëpi valëviten flamuri i Çamërisë, i Holandës dhe i ShBA-së. Çamëria është një rajon mes Shqipërisë dhe Greqisë, që dëshiron pavarësinë. Lato e kishte shpallur veten president të rajonit të Çamërisë.



Gjykata Speciale ka vazhduar dërgimin e ftesave për intervistim ndaj ish-drejtimesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

Specialja 'godet' skenën politike në Kosovë

Gjykata Speciale javën e kaluar ka trazuar skenën politike me dërgimin e ftesave për intervistim të ish-drejtimesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Përveç Ramush Haradinajt, ftesë për t'u intervistuar nga Specialja ka marrë edhe ish-zëdhënësi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Jakup Krasniqi, ish-shefi i këtij shtabi, Bislim Zyrtari, dhe ish-anëtari i Shtabit të UÇK-së, Sokol Bashota. Ata kanë pranuar t'i përgjigjen kësaj gjykate, duke premtuar se do ta mbrojnë pastërtinë e luftës së UÇK-së. Deri më tani dhjetëra ish-pjesëtarë të UÇK-së kanë marrë ftesa për intervistim qoftë në cilësinë e të dyshuarit, qoftë të dëshmitarit

së drejtë e të pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkundër qëndrimit tim të hapur kritik e kundërshtues për krijimin me presion të kësaj gjykate, unë do të prezantohem në hetuesinë e saj në datën e caktuar në cilëndo cilësi. Me besim në drejtësinë, i bindur se e vërteta është që gjatë luftës në Kosovë, Serbia ka kryer gjenocid, kurse konstruktet e saj monstruoze për UÇK-në do të bien poshtë, unë do të jem atje për ta dhënë kontributin tim për ndriçimin e së vërtetës historike", ka deklaruar ai, duke shtuar se në vend se Serbia të ballafaqohet me drejtësi për krimet e luftës, po ballafaqohet Kosova me akuzat e trilluara. "Megjithatë, është fatkeqësi dhe ironi e llojit të vet, që në vend se Serbia të përballet me drejtësinë për krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidit, ne duhet të mbrohemi nga akuzat e saj të trilluara; në vend se të

gjykoen argumentet dhe provat e pamohueshme dhe të njohura botërisht, drejtësia merret me trille dhe shpifje të ulëta të politikës serbe dhe të shërbimeve të saj sekrete. Përkundër bindjeve të mia sa i përket kësaj gjykate politike, të krijuar me presion politik nga njerëzit që bartin funksione të larta shtetërore në Kosovë dhe themelimin e saj me votën e atyre deputetëve që ishin numra në Kuvendin e Kosovës, unë do të prezantohem në hetuesinë e Gjykatës Speciale", është shprehur Krasniqi. Ai ka rikujtuar se kjo nuk do të jetë hera e parë që del para hetuesve për të dhënë përgjigje për çështje të sajura nga pushteti i Serbisë. "Ja kam dalë në proceset e hetuesisë jugosllave të viteve tetëdhjetë, siç ia kam dalë me përgjegjësi edhe kur jam ftuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi, për rastet e kur-

disura në bazë të dosjeve të dorëzuara nga Serbia kundër Fatmir Limajt, Ramush Haradinajt dhe bashkëluftëtarëve të tyre. Në të dy rastet kam dhënë deklarata në cilësinë e zëdhënësit të UÇK-së, përfaqësuesit të saj politik dhe anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së gjatë luftës së viteve 1998-1999. Deklaratat e mia në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi janë publike, siç është publik edhe verdikti i kësaj gjykate kur i hodhi si të pabaza të gjitha akuzat kundër Fatmir Limajt dhe Ramush Haradinajt, duke shpallur pafajësinë e tyre. As kësaj radhe nuk mund të jetë ndryshe", ka thënë Krasniqi.

Të ftuar nga Gjykata Speciale janë edhe dhjetëra ish-drejtimes të UÇK-së, përfshirë këtu Sami Lushtakun, Rrustem Mustafën, Sylejman Selimin, Shukri Bujën dhe figura të tjera.

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 21 KORRIK - Në javën e kaluar Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim figura të rëndësishme të skenës politike në Kosovë. Në mesin e tyre është edhe Ramush Haradinaj, i cili ka dhënë dorëheqje nga posti i kryeministrit pikërisht për shkak të ftesës nga Specialja në cilësinë e të dyshuarit.

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se në Hagë do të dalë përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Ai ka thënë se pastërtia e tij dhe lufta e UÇK-së nuk mund të njolloset nga askush dhe asnjëherë. "Qeveritë dhe pushtetet janë të ndërrueshme, jetojmë në demokraci. Nderi i kryeministrit dhe shtetit duhet të ruhet dhe unë nuk e poshtëroj asnjëherë. Në Hagë si Ramush Haradinaj do t'u dal përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Pastërtia ime dhe e luftës së UÇK-së, e konfirmuar nga dy aktgjykime, nuk mund të njolloset nga askush dhe asnjëherë", ka theksuar Haradinaj.

Ftesë nga Gjykata Speciale ka marrë edhe ish-zëdhënësi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Jakup Krasniqi, i cili ka bërë me dije se më 24 korrik do të paraqitet në Hagë. Krasniqi ka thënë se do të shkojë në Hagë për ta dhënë kontributin

për ndriçimin e së vërtetës historike. "Pavarësisht prej bindjeve të mia që Gjykata Speciale, e ngritur mbi bazën e raportit të Dick Martit, miratuar nga Këshilli i Evropës, i cili fund e krye është sajuar në Beograd me shpifje e gënjeshtër dhe me motiv e qëllim të komprometit dhe inkriminimit të luftës



Në Rugovë të Pejës fillon kampi veror i diasporës

PEJË, 21 KORRIK (ER) - Në kuadër të organizimit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) për "Ditët e Diasporës", të shtunën në Rugovë të Pejës ka nisur kampi diaspora. Më shumë se 30 fëmijë nga vende

të ndryshme të Evropës po marrin pjesë në këtë kamp, i cili ka për qëllim kryesor krijimin dhe forcimin e lidhjes mes fëmijëve dhe vendlindjes së tyre.

Përmes aktiviteteve dhe lojërave të shumta që organizohen në kamp,

synohet ruajtja e traditës, kulturës dhe gjuhës shqipe. Fëmijët do të arrijnë të krijojnë lidhje shoqërore edhe me fëmijët nga Kosova, duke forcuar kështu dashurinë për vendlindjen. Kampi diaspora do të zgjasë deri më 24 korrik.



Flet për "Epokën e re", Ali Lajçi

GJENDJA NË KOSOVË MUND TË NDRYSHOJË NËSE KRYEMINISTRI VJEN NGA VETËVENDOSJA

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka bërë me dije se janë për bashkëpunim me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) por, sipas tij, ndryshimet në vend mund të vijnë vetëm nëse Lëvizja Vetëvendosje udhëheq postin e kryeministrit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Lajçi ka theksuar gjasat janë që Lëvizja Vetëvendosje të dalë parti e parë dhe ta ketë postin e kryeministrit. Ai ka pohuar se mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme nuk duhet të shtyhet më shumë se në muajin shtator

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka treguar se parimisht janë pro bashkëpunimin me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Ai ka thënë se posti i kryeministrit duhet t'i takojë subjektit i cili merr numrin më të madh të votave në zgjedhje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lajçi ka thënë se gjasat janë që Lëvizja Vetëvendosje të dalë subjekti i parë politik. "Në parim po, derisa të hyjmë në vota. Kur të futemi në vota secili duhet ta pranojë votën reale. Pra, kush të dalë i pari i takon posti i kryeministrit. Gjasat janë që ne të jemi parti e parë dhe ta kemi kryeministrin. Kjo është edhe në interes të Kosovës", ka thënë Lajçi. Ai ka deklaruar se ndryshimet në Kosovë janë të mundshme vetëm nëse kryeministri është i Vetëvendosjes. Sipas tij, nëse LDK-ja del subjekti i parë politik është rrezik që ajo të shkojë në bashkëqeverisje me PDK-në. "Elektorati duhet të votojë për Vetëvendosjen që të dalë e para si subjekt politik, sepse e merr LDK-në. Kurse, nëse del e para LDK-ja është rrezik që të shkojë me PDK-në,

prandaj votuesit duhet të kenë kujdes", është shprehur ai.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje ka thënë se zgjedhjet e parakohshme nuk duhet të shtyhen më shumë se në muajin shtator. "Kryetari i Republikës ka të drejtë kushtetuese ta bëjë një propozim për një mandat të ri nëse ka konsensus dhe i votohet në Kuvend. Përndryshe, zgjedhjet janë në rend dhe nuk ka shpëtim. Ato duhet të mbahen sa më shpejt. Mbajtja e zgjedhjeve nuk duhet të shtyhet më shumë se në muajin shtator", ka thënë Lajçi.

"Epoka e re": Z. Lajçi, kryeministri Haradinaj ka dhënë dorëheqje për shkak të ftesës që ka marrë nga Gjykata Speciale. A ka vepruar në mënyrën e duhur?

Lajçi: Shumë është kompleksive kjo. Varet se si e trajtojnë njerëzit këtë veprim. Në nivel të parë, sipas meje, është se kur ka hyrë në atë firmë administrative si kryeministër i PAN-it ai ka qenë i dështuar. Qysh në fillim të mandatit e ka miratuar demarkacionin me Malin e Zi, të cilin e ka kundërshtuar dikur. Dhe, siç dihet, kjo marrëveshje është një demilitim i ri i kufirit me Malin e Zi, duke e rrudhur territorin e Kosovës. Faktikisht, qysh atëherë kur Kuvendi me 80 vota

e ka ratifikuar këtë marrëveshje e cila përcakton një vijë të re kufitare ka rënë edhe Kuvendi i Kosovës. Ndërsa, siç e dimë, Ramushi sa ishte në opozitë ka qenë premtues i madh për të mos u miratuar ajo marrëveshje, pastaj kur erdhi në pushtet e votoj të njëjtin projekt me deklarata të Thaçit dhe jo të vetat. Në këtë mënyrë Haradinaj ia ka zgatur jetën edhe Hashim Thaçit. Edhe qeverisja e tij ka qenë skandaloze dhe me defekte të mëdha, duke filluar prej ndarjes së buxhetit, rritjes së pagës për vete dhe mosliberalizimit të vizave.

Pastaj formimi i ekipit negociator që ishte antikushtetues, të cilin, si të tillë, e deklaroi vetë Gjykata Kushtetuese. Mendoj se me vendimin e Kushtetueses për këtë ekip ka rënë qeveria dhe presidenti, i cili për këshilltar ka pasur njeriun e UDB-së. Me këtë rast, ai e ka pranuar fajin sepse e ka shkarkuar atë këshilltar të UDB-së. Këto janë gjëra skandaloze. Madje, ky president e ka vendosur territorin e Kosovës në pazar. Në këtë mandat qeverisës ka vazhduar degradimi institucional në të gjitha fushat. Prandaj, Kosova duhet të zgjedhë që të bëjë ndryshime përmes votës së lirë. Nuk mund të durohen më këto keqmenaxhime.

"Epoka e re": Në ditën që ka dhënë dorëheqje Haradinaj, ai e ka formuar trupën punuese për rishikimin dhe korrektimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Si e keni parë këtë veprim të tij?

Lajçi: Kanë pushuar ato, sepse kryeministri ka dhënë dorëheqje. Tani gjithçka është jashtë funksionit të tyre. Këtë veprim ky nuk e ka bërë me kohë, madje e ka votuar projektin e Thaçit për demarkacionin.

"Epoka e re": Kur mendoni se është koha më optimale që të mbahen zgjedhjet e parakohshme?

Lajçi: Kryetari i Republikës ka të drejtë kushtetuese ta bëjë një propozim për një mandat të ri nëse ka konsensus dhe i votohet

në Kuvend. Përndryshe, zgjedhjet janë në rend dhe nuk ka shpëtim. Ato duhet të mbahen sa më shpejt. Mbajtja e zgjedhjeve nuk duhet të shtyhet më shumë se në muajin shtator.

"Epoka e re": Si mendoni se do të dalë Lëvizja Vetëvendosje në këto zgjedhje?

Lajçi: Ndryshime në Kosovë mund të bëjë vetëm projekti i Lëvizjes Vetëvendosje. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja deri më tani kanë administruar me një model dështues. Isa Mustafën e ka rrëzuar Kuvendi. Ramushi është tërhequr për shkak të krizës së vet të brendshme dhe problemeve të tjera, ndërkaq PDK-ja ka mbetur duke kalkular çdoherë në interes të vetin.



Faktikisht ky subjekt politik ka rënë dhe duhet të bjerë edhe më tutje. Në këtë mënyrë e vetmja alternativë logjike, programore dhe juridike mbetet Lëvizja Vetëvendosje, sepse ka një program dallues prej subjekteve të tjera politike dhe ende nuk është provuar qeverisja e saj. Prandaj, populli i Kosovës duhet ta votojë këtë lëvizje dhe të shohim se çka mund të bëjmë, me gjithë vështirësitë që kanë me qenë të shumta në menaxhim dhe në ristrukturim. Bile duhen edhe ndryshime kushtetuese, sepse kjo Kushtetutë nuk e lejon sovranitetin e plotë të republikës.

"Epoka e re": Tanimë janë shtuar përpjekjet për një

bashkëpunim në mes të LDK-së dhe LV-së. Sa është i mundshëm një bashkëpunim i tillë, meqenëse ju dikur keni qenë pjesë e LDK-së?

Lajçi: Për shkak të interesit të vendit ne do të gjejmë të gjitha mundësitë që të bashkëpunojmë dhe ta ndryshojmë gjendjen që Kosova të shkojë drejt një shteti ligjor pa të cilin nuk mundemi. Tani LDK-ja i ka zgjedhjet e brendshme dhe të shohim se kush po fiton. Pra, në parim jemi për bashkëpunim.

"Epoka e re": Por të dy partitë po pretendojnë ta marrin postin e kryeministrit. A mund të arrihet një kompromis për këtë çështje?

Lajçi: Ne mendojmë se

ndryshimet mund të vijnë vetëm nëse Lëvizja Vetëvendosje ka postin e kryeministrit. LDK-ja ende nuk ka program dallues prej partive të tjera. Gjendja në Kosovë mund të ndryshojë vetëm nëse kryeministri vjen nga Lëvizja Vetëvendosje.

"Epoka e re": Pra, ju mund të bashkëpunoni me LDK-në vetëm nëse ju jepet posti i kryeministrit?

Lajçi: Në parim po, derisa të hyjmë në vota. Kur të hyjmë në vota secili duhet ta pranojë votën reale. Pra, kush të dalë i pari i takon posti i kryeministrit. Gjasat janë që ne të jemi parti e parë dhe ta kemi kryeministrin. Kjo është edhe në interes të Kosovës.

"Epoka e re": Mirëpo deri më tani kemi parë disa raste që postin e kryeministrit e kanë marrë edhe partitë që nuk kanë dalë të parat?

Lajçi: Rregull kushtetues është që partia e parë ta marrë këtë post. Ekziston edhe mundësia e marrëveshjeve që partia e parë nuk e merr postin e kryeministrit, por ia jep të dytës apo të tretës, varësisht se si janë marrë vesh. Shembull kështu ka ndodhur kur PDK-ja ia ka dhënë

këtë post Isës.

"Epoka e re": Pra, nuk e shihni ndonjë problem që të bashkëpunoni me LDK-në edhe nëse nuk e merrni postin e kryeministrit?

Lajçi: Elektorati duhet të votojë për Vetëvendosjen që të dalë e para si subjekt politik, sepse e merr LDK-në. Kurse nëse del e para LDK-ja atëherë është rrezik të shkojë me PDK-në, prandaj votuesit duhet të kenë kujdes.

NË PRISHTINË VIHET GURTHEMELI I BUSTIT TË SENATORIT BOB DOLE

PRISHTINË, 22 KORRIK - Në shenjë respekti për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, në shënimin e ditëlindjes së senatorit amerikan Bob Dole, në Prishtinë të hënën është vënë gurthemeli për ndërtimin e bustit të tij. Në këtë shënim kanë marrë pjesë ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj dhe drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka.


Gjatë fjalimeve u tha se për këtë nismë institucionet e Kosovës kanë marrë edhe pëlqimin e senatorit Dole. "Ishte viti 1990 kur u realizua vizita e parë e delegacionit të senatorëve të lartë amerikanë në Kosovë, e cila ishte një kthesë për ne", ka thënë Haradinaj, duke rikujtuar edhe takimin e senatorit Dole me liderin e atëhershëm poli-

tik të shqiptarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova.

Kurse ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se ai dhe senatori Dole ndihen shumë të nderuar me iniciativën për ndërtimin e bustit për senatorin amerikan. "Të gjithëve do të na bënte mirë ta ndiqnim filozofinë e Bob Dole. Në politikë ka kundërshtarë, jo armiq", ka deklaruar ambasadori amerikan.

Ndërtimi i bustit të senatorit Bob Dole do të bëhet nga Luan Mulliqi.

Projekti do të financohet nga Oda Amerikane në Prishtinë. Ish-presidenti Bill Clinton, ish-sekretarja e shtetit Madeline Albright dhe tani Bob Dole janë personalitetet të cilave u janë bërë apo bëhen shtatore, siç është rasti me Bob Dole, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë.



Në Sheshin 'Adem Jashari' në Skenderaj hapet Panairi i Veshjeve Tradicionale

SKENDERAJ, 22 KORRIK (ER) - Është hapur Panairi i Veshjeve Tradicionale në Sheshin "Adem Jashari" në Skenderaj. Kryetari i komunës, Bekim Jashari, ka thënë se në këtë panair shumë gra të suksesshme paraqiten me artin e punimeve të dorës. "Ky aktivitet, që është pjesë e organizimeve të shumta të nisura javën e kaluar për nder të

bashkatdhetarëve, veç mundësisë që u ofrohet këtyre zonjave në veprimtarinë artizanale t'i sheshin punimet e tyre, është rast i mirë edhe për gjeneratën e re të lindur në shtetet larg Kosovës, që t'i njohin për së afërmi traditën dhe kulturën e pasur të veshjeve tona tradicionale", ka thënë kryetari Jashari.



Ndahen gjashtë motokultivatorë për fermerët e Komunës së Drenasit

DRENAS, 22 KORRIK (ER) - Komuna e Drenasit, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare IADK, përkrahur nga GIZ-i gjerman, ka ndarë gjashtë motokultivatorë për përfituesit e projektit për bimë mjekësore aromatike. Këto pajisje do të ndikojnë në lehtësimin e punëve dhe do ta rrisin efikasitetin për kultivim si dhe zgjerimin e sipërfaqeve të

kultivuara me këto lloje të bimëve. Gjithashtu, organizata IADK do t'i përkrahë fermerët me këshilla teorike dhe praktike. Me këtë rast, drejtoresha e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Anita Avdullahu-Dvorani, ka falënderuar IADK-në për bashkëpunimin e vazhdueshëm në përkrahje të fermerëve të Komunës së Drenasit.

Juniku ndan çmimin 'Qytetar Nderi' për Courtney Creshaw dhe Maxwell Gruber

JUNIK, 22 KORRIK (ER) - Komuna e Junikut, në shenjë nderi dhe respekti për kontributin e dhënë për avancimin e gjuhës angleze, si dhe realizimin e projekteve të shumta në fushën e kulturës, rinisë, sportit dhe ambientit, në bashkëpunim me shkollat në Komunën e Junikut dhe komunitetin, ndau çmimin "Qytetar Nderi" për Courtney Creshaw dhe Maxwell Gruber, anëtarë të Korpusit të Paqes. Kryetari i Junikut, Agron Kuçi, ka falënderuar qytetarët më të rinj të

Junikut Courtney dhe Max për angazhimin dhe kontributin e tyre në Junik si dhe ka shprehur nderin e tij personal dhe të qytetarëve të Junikut që patën nderin të punojnë dhe bashkëjetojnë për këto vite me Courtney dhe Maxwellin. Në fjalën e tyre përshëndetëse para bashkëpunëtorëve dhe qytetarëve të Junikut, Courtney dhe Maxwell thanë se e kishin shumë të lehtë integrimin në Junik, pasi institucionet e kësaj komune dhe qytetarët hapen derën dhe zemrën për ta.



Ekrem Duraku nga Krusha e Madhe, një ndër fermerët më të mirë

RAHOVEC, 22 KORRIK (ER) - Kultivimi i bimëve perimore në ambiente të mbrojtura siguron qëndrueshmëri të lartë të bimëve, njëkohësisht siguri në ushqim. "Ekrem Duraku nga Krusha e Madhe nuk është një fermer i zakonshëm. Ai është një ndër fermerët më të mirë i cili kultivon disa lloje të perimeve në ambiente të mbrojtura dhe ato të hapura. Në sipërfaqen e mbrojtur prej 25 ari fermeri arrin që të marrë rendiment mjaft të mirë si dhe t'i plasojë ato në tregun vendor në kohën kur prodhimet e huaja pushtojnë tregun tonë", është bërë me dije në njoftimin e Drejtorisë së Bujqësisë. Drejtorja e Bujqësisë ka njoftuar se si përfitues i serës pesë ari nga Komuna e Rahovecit, Ekrem Duraku ka arritur që këtë sipërfaqe ta rrisë në 25 ari dhe të krijojë një ekonomi familjare në të cilën ka arritur të sigurojë të ardhurat të mjaftueshme për të dhe familjen.



Laboratori i QMF-së në Duhël është funksional

SUHAREKË, 22 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka vizituar Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në Duhël. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se laboratorit i QMF-së në Duhël është funksional. "Qytetarët mund t'i kryejnë shërbimet shëndetësore ashtu siç e kemi njoftuar opinionin", ka shkruar kryetari Muharremaj.



Veseli kërkon nga kryetarët e degëve formimin e shtabeve zgjedhore

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka mbajtur të hënën një takim me kryetarët e degëve të partisë, ku është diskutuar për zhvillimet e fundit në vend. Veseli ka thënë se PDK-ja është gati për zgjedhje dhe në këtë proces hyn për të fituar. "Tashmë data e zgjedhjeve duhet të cakto-

het sa më parë. Ne kemi përfunduar procesin e brendshëm zgjedhor, që ka fuqizuar PDK-në, dhe jemi të përgatitur për zgjedhje si asnjëherë më parë", është shprehur Veseli.

Në takim është vendosur që të gjitha degët e PDK-së t'i krijojnë shtabet zgjedhore gjatë kësaj jave dhe, po ashtu, është kërkuar nga kryetarët e

degëve që t'i fillojnë propozimet për kandidatët për deputetë që do të jenë pjesë e listës kandiduese të PDK-së. "PDK-ja hyn në zgjedhje me qëllimin e qartë për të fituar në këtë proces dhe për t'i dhënë vendit një qeveri me legjitimitet të plotë qytetar dhe me vizion të qartë për të ardhmen euroatlantike", ka thënë Veseli.



Fillon aplikimi për kompensimin e mësimdhënësve të viteve të '90-ta

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Mësimdhënësit të cilët kanë punuar gjatë periudhës së viteve '90-ta, në kuadër të procesit të njohur si sistemi paralel i arsimit në Kosovë, do të mund të aplikojnë për të përfituar nga Ligji për Statusin e Punëtorëve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në 1999. Kjo pasi ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka nënshkruar të hënën udhëzimin administrativ i cili përcakton kushtet e aplikimit. "Jam shumë i lumtur që sot kam nënshkruar Udhëzimin Administrativ për kushtet dhe kriteret e realizimit të së drejtës në kompensim shtesë për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, si dhe Udhëzimin Administrativ për pronarët e



shtëpive shkolla dhe objektet e tjera të lëshuara për arsimin shqip gjatë viteve 1990/99", ka thënë ministri Bytyqi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se me hyrjen në fuqi të këtyre dy udhëzimeve do të zbatohet Ligji për Statusin

e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, ligj ky që është miratuar gjatë mandatit të tij si ministër i Arsimit. "Punonjësit e arsimit dhe kryefamiljarët që lëshuan objektet për shtëpi-shkolla gjatë periud-

hës 1990-1999 do të mbeten përherë pjesë e historisë më të lavdishme të popullit shqiptar", ka thënë ministri Bytyqi. Mësimi në Kosovë gjatë viteve të '90-ta është zhvilluar nëpër shtëpitë-shkolla, sipas organizimit paralel që kishin vendosur atëkohë përfaqësuesit

politikë shqiptarë, duke kundërshtuar nënshtrimin ndaj politikës së Beogradit dhe ish-liderit të atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq. Punëtorët, të cilët e kanë ushtruar profesionin e tyre gjatë asaj periudhe, pritet t'i marrin përfitimet pas daljes në pension. Ata do të marrin nga 19 deri në 95 euro, varësisht sa vjet kanë punuar në arsim. Pra, bazuar në një llogaritje të bërë, një mësimdhënës që ka punuar 9 vjet do të "shpërblehet" me 95 euro në muaj dhe pension kontributpagues prej 260 eurosh. Kjo nënkupton se ata do të paguhet 355 euro në muaj. Ndërkaq, në rast se personi ka ndërruar jetë, të drejtë kompensimi ka bashkëshortja ose bashkëshorti. Përveç mësimdhënësve, sipas ligjit edhe pronarët e shtëpive që në atë kohë kanë lëshuar objektet e tyre të shfrytëzohen si shkolla, do të gëzojnë përfitime si dhe punëtorët teknikë dhe shërbyesit.

135 tituj librash të blerë dhe të përkrahur për botim nga MKRS-ja i dhurohen FSK-së

Ministri Gashi ka thënë se kanë ndërmarrë një iniciativë për t'i furnizuar bibliotekat e komunave me libra. "Në kuadër të kësaj kemi menduar ta furnizojmë edhe bibliotekën e ushtrisë sonë, po ashtu edhe pjesën lindore të Kosovës, Preshevën, Medvegjën, Bujanocin si dhe Ulqinin dhe Tuzin", është shprehur Gashi.

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar të hënën Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK), ku është pritur në takim nga gjenerali Enver Cikaqi. Qëllimi i kësaj vizite ishte dhurimi i librave të botuar dhe të blerë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për bib-

liotekën e FSK-së. Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se kanë ndërmarrë një iniciativë për t'i furnizuar bibliotekat e komunave me libra. "Në kuadër të kësaj kemi menduar ta furnizojmë edhe bibliotekën e ushtrisë sonë, po ashtu edhe pjesën lindore të Kosovës, Preshevën, Medvegjën, Bujanocin si dhe Ulqinin dhe Tuzin", është shprehur Gashi.

Ai ka shtuar se furnizimi me libra nëpër biblioteka të komu-



nave të Kosovës si dhe jashtë territorit të Kosovës është një program i rëndësishëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Në kuadër të këtij

programi ne po dhurojmë në çdo bibliotekë nga 135 tituj, të cilët janë më të kërkuar nga publiku kohën e fundit. Duke pasur parasysh që kohën e fun-

dit nuk ka pasur investime në libra ne kemi vendosur që t'i mbështesim bibliotekat me këtë donacion, i cili besoj se do të vazhdojë edhe në të ardhmen", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq gjenerali Enver Cikaqi ka falënderuar ministrin Gashi për vizitën dhe dhurimin e librave për bibliotekën e FSK-së dhe e ka njoftuar ministrin rreth bibliotekës dhe interesimin e pjesëtarëve të FSK-së për leximin e librave. "Këta tituj do t'i ndihmojnë shumë pjesëtarët tanë për formësimin dhe avancimin profesional, njëkohësisht do ta kemi një bibliotekë më të begatshme. Ardhja juaj këtu për t'i sjellë librat është një mesazh që FSK-ja është mbarë dhe ndihemi të përkrahur edhe nga të tjerët", është shprehur gjenerali Enver Cikaqi.

OAK-u njofton drejtorin e AKP-së me problemet që kanë bizneset në raport me objektet dhe pronat



PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Përfaqësues të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) janë pritur të hënën në takim nga drejtori i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Valon Tolaj.

Kryetari i Bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka përgëzuar Valon Tolajn për pozitën e tij të re dhe e ka njoftuar atë për problemet që po i shqetësojnë aktualisht bizneset në raport me objektet dhe pronat.

Krasniqi ka kërkuar nga drejtori i

AKP-së t'i shikojë mundësitë për kohëzgjatjen e qirasë së objekteve ngaqë me rregullore të AKP-së biznesi ka të drejtë ta huazojë objektin me qira vetëm për periudhën njëvjeçare, duke theksuar se kjo gjë po paraqet pengesë të madhe dhe pasiguri të bizneset. Ai ka thënë se bizneset janë faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në vend dhe në këtë drejtim ka kërkuar që të largohen barrierat ndaj tyre dhe jo të rëndohen më tepër.

Ndërkaq drejtori i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Valon Tolaj, ka falënderuar përfaqësuesit e OAK-së për vizitën dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me Odën e Afarizmit të Kosovës dhe bizneset. Tolaj ka thënë se është duke bërë përpjekje për shtimin e afateve sa i përket kohëzgjatjes së kontratës të objekteve me qira, duke u krijuar lehtësira dhe siguri më të madhe bizneseve gjatë operimit të tyre.

Shala nënshkruan vendimin për ndërtimin e inkubatorit të bizneseve në Skenderaj

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në vazhdim të mbështetjes për bizneset, të hënën ka nënshkruar vendimin mbi dhënien e pëlqimit për themelimin e inkubatorit në Komunën e Skenderajt.

Ministri Shala theksoi se inkubatori do t'u shërbejë bizneseve që të kenë kushte sa më të mira të operimit dhe të jenë konkurruese. "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është duke krijuar mundësi për bizneset në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, duke ndër-tuar inkubator dhe zona ekonomike. Inkubatori në Komunën e Skenderajt do të ketë sipërfaqe mbi 9 mijë metra katrorë dhe është një mundësi e mirë për

zhvillimin e afarizmit në këtë komunë", ka thënë ministri Shala. Ai ka theksuar se roli i ministrisë është krijimi i kushteve sa më të mira për bizneset, duke punuar shumë për fuqizimin e tyre që të jenë konkurruese.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka financuar edhe ndërtimin e inkubatorit në Komunën e Malishevës, që së shpejti do të jetë funksional. Po ashtu, MTI-ja është duke vazhduar ndërtimin e zonave ekonomike, që bizneseve vendore dhe të huaja t'u krijoj hapësirë të mjaftueshme për të operuar me kosto shumë të lirë. Investimi në Komunën e Skenderajt do të vazhdojë edhe në projekte të tjera të rëndësishme.



MPMS-ja, apel pensionistëve: Mos bini pre e lajmeve të rreme



EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 KORRIK - Në rrjetet sociale është duke qarkulluar një njoftim: "Lajmërohen të gjithë pensionistët e Republikës së Kosovës që përfundimisht janë në listat e Qeverisë së Republikës së Kosovës më 31. 12. 1998, që sipas vendimit të Strasburgut duhet të paguhet nga ana e Republikës së Serbisë, prej kur u është ndërpre pensioni e derisa t'i marrin ato në tërësi, qoftë krejt përmjetherë apo me rata. Adresa e paraqitjes është në 'Grand Hotel', Prishtinë,

kati i III, nr. 306", thuhet në këtë njoftim që mban nënshkrimin: Nga Avokati dhe Koordinatori - Këshillëdhënës, Eksperti Gjyqësor i Gjykatave Vendore dhe Ndërkombëtare".

Në lidhje me këtë njoftim ka reaguar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Mimoza Kqiku, këshilltare për informim e MPMS-së, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Departamenti i Pensioneve nuk korrespondon fare me një veprim të tillë, njëkohësisht konstaton se është një informatë e cila nuk përkon me realizimin e pension-

eve në këtë formë. "U bëjmë apel të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe personave të apostrofuar në këtë e-mail, që të kenë kujdes për veprimet që do t'i bëjnë në bazë të ftesës së atyre personave. Njëkohësisht, MPMS - Departamenti i Pensioneve, është në vazhdimësi i angazhuar që realizimi i të drejtës për pensione për ish-pensionistët e viteve të '90-'98 të bëhet përmes bazës ligjore dhe përkrahjes institucionale. Për çdo eventualitet Departamenti i Pensioneve është në nivel të detyrave dhe përgjegjësi", ka thënë Kqiku.



RUKIQI: SITUATA POLITIKE DO TË NDIKOJË NË KLIMËN E BIZNESIT

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka folur për zhvillimet e fundit politike në vend, duke theksuar se kjo do të ndikojë në ambientin biznesor. Ai ka thënë se zgjedhjet e parakohshme do të krijojnë mangësi në vendimmarrje në disa ligje, projekte dhe propozime që nxisin investimet e huaja të drejtpërdrejta

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në konferencën e rregullt për medie ka folur për zhvillimet e fundit politike në vend ku, sipas tij, këto zhvillime do t'i prekin proceset ekonomike. "Shumë ligje kanë mbetur në procedurë dhe aktivitetet e tjera do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë te bizneset. Kanë qenë në procedurë ligjet më të rëndësishme tatimore, ka pasur shumë aktivitete sa i përket rregullimit në sektorin e energjisë, ka pasur aktivitete në sektorin e ndërtimit, kemi pasur proces të avancimit të çështjes publiko-pri-

vate, gjithashtu kemi pasur fokus të madh për trajtimin e çështjes së informalitetit. I gjithë ky zhvillim i ri politik në vend do të jetë një pauzë për të gjitha këto çështje", ka deklaruar Rukiqi. Ai ka folur edhe për Termocentralin "Kosova e Re". "Sa i përket 'Kosovës së Re' kemi një investitor, por parakusht është vendimmarrja me 2/3 e Kuvendit të Kosovës. Deri në përbërjen e re të Kuvendit nuk mund të presim vendimmarrje. A mund të ketë rrezik? Po, mund të ketë. Nga zotimet e qeverisë së re, por edhe nga investitorët ndërkombëtarë kërkohet që projektet e kësaj qeverie të vazhdojnë edhe me qeverinë e ardhshme", është shprehur Rukiqi.

'Abi Çarshia' paraqet kallëzim penal për rrënim të objektit

Drejtorja e Inspektoratave në Komunën e Prizrenit këto ditë ka zhvilluar një aksion për rrënimin e një pjese të objektit pa leje të qendrës tregtare "Abi Çarshia" në rrugën "Tirana". Në këtë aksion më pas u përfshinë edhe disa aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, për të cilën gjë pati edhe reagime nga të dyja palët. Të hënën në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK) është mbajtur një konferencë për medie, në të cilën janë shpalosur detaje të rrënimin të kësaj pjese të objektit në "Abi Çarshia".

Avokati i kompanisë "Abi Çarshia", Taulant Hodaj, ka thënë se Udhëzimi Administrativ i nënshkruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për legalizim të objekteve është publikuar në gazetën zyrtare por, sipas tij, edhe përkundër kësaj, Komuna e Prizrenit është përgjigjur se nuk ka marrë njoftim, për çka kompania "Abi Çarshia" është përballur me probleme të ndërtimit. "Ndërtimi i 'Abi Çarshia' është komplet i ndërtuar në pronë private të kompanisë dhe nuk qëndron asnjë fakt se aty ka qenë pronë publike. Asnjë centimetër

nuk është pronë publike. Në vitin 2004 ka qenë një plan që të kalojë një rrugë aty për qoshe dhe kurrë nuk kanë qenë të njoftuar pronarët e kompanisë për këtë plan. Është marrë leja për ndërtim dhe kompleksi ka përfunduar në qershor të vitit 2018. 15 për qind është tejkalim i lejes së ndërtimit. Ky është objekti i vetëm që ka marrë leje për ndërtim dhe asnjë tjetër në Prizren nuk ka leje ndërtimi. Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje thotë se 'çdo ndërtim i përfunduar duhet të trajtohet para datës së hyrjes në fuqi'. Udhëzimi administrativ është nënshkruar nga ministri në vitin 2019 dhe ka hyrë në fuqi. Prej kësaj date e kemi mbledhur dokumentacionin. Kemi aplikuar më 18. 7. 2019. Komuna e Prizrenit na ka lëshuar një kopje dhe thotë se: 'Nuk jemi të njoftuar se ka udhëzim administrativ', ndërsa ai është publikuar në gazetën zyrtare. Në përgjigjen e komunës thuhet se Komuna e Prizrenit nuk ka asnjë shkresë zyrtare nga MMPH-ja për legalizim", ka deklaruar Hodaj. Ai ka shtuar se tashmë kjo çështje është dërguar në gjykatë. "Udhëzimi administrativ ka hyrë në fuqi dhe është

publikuar në gazetën zyrtare. Jemi në procedurë të trajtimit në gjykatë për kompensim dhe është dërguar kallëzim penal ndaj personave që kanë bërë këtë veprim", është shprehur Hodaj. Sa i përket përlëshjes së aktivistëve të LV-së, avokati Hodaj ka theksuar se kjo ka ndodhur spontanisht dhe ka mohuar të ketë pasur urdhër nga pronarët apo menaxhmenti i "Abi Çarshia" për t'i sulmuar ata. Sipas tij, përderisa ndodhte rrënimi, aktivistët e LV-së kanë hyrë duke duartrokitur, që sipas Hodajt, ka shkaktuar dhe konfrontime të rastit. "Është për keqardhje që i jepet konotacion politik. Atë ditë nuk kam qenë aty, por aktivistët kanë hyrë në pronë private dhe kur ka filluar të rrënohet objekti, ata kanë duartrokitur. Aty është krijuar një përlëshje. Nuk e di çfarë kërkojnë aktivistët në pronë private. Sa iu përket deklaramëve në medie se ata janë kërcënuar nga punonjës të 'Abi'-it, kjo është dezinformatë politike. Aty ka mllef të jashtëzakonshëm. Kanë kërkuar falje publike, por asnjë zyrtar i 'Abi'-it nuk është i përfshirë. Janë dezinformime politike", ka deklaruar Hodaj.

Lluka dhe kryeshefi i KRU 'Prishtina' diskutojnë për projektet e radhës në ujësjellës

Prishtinë, 22 korrik (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të hënën në takim kryeshefin ekzekutiv të Ujësjellësit të

Prishtinës, Ilir Abdullahu, me të cilin ka diskutuar për projektet e radhës në ujësjellës. Ministri Lluka ka thënë se këto projekte kanë të bëjnë krye-

sisht me digitalizim, siç janë: pagesa përmes aplikacionit në telefon të faturave të ujit, digitalizimi i rrjetit për qasje online (open data), identifikimi i

humbjeve të ujit në mënyrë digjitale dhe investimi për trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë që do të fillojë së shpejti.



Përvjetor

Ymer Alushani, luani i Grykës së Llapushnikut

Zeqir BEKOLLI

Nën shpatet e vargmaleve të Berishës, aty ku fusha bashkëngjitet me bjeshkën, jeton familja Alushani nga Komorani i Drenicës e cila me veprimtarinë patriotike i krijoi një histori të lavdishme vetes, që do të bartet brez pas brezi.

Lavdia e kësaj familjeje, me një origjinë të lashtë, do të jetë e pranishme sa herë që historia jonë do t'i kthehet kujtesës. Të parët e Alushanëve flitet se kanë ardhur nga Lushnja e Shqipërisë. Muharremi, babai i Ymer Alushanit-"Vogëlushit", ka qenë një burrë i njohur në Drenicë. Për shkak të lidhjeve që pati me grupin patriotik të Berishëve, i udhëhequr nga Rifat Berisha, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në vitin 1952, dënohet me 20 vjet burgim të rëndë, të cilat do t'i mbajë në burgjet e Serbisë dhe në ishullin e Goli Otokut të Kroacisë, i njohur për tortura çnjerëzore.

Regjimi i Titos i shoqëruar nga kriminelit serb Aleksandër Rankoviç në vitet e '60-ta po bënte tortura të nduarnduarta mbi popullatën në Drenicë. Familja Alushani asokohe ishte e privuar nga të gjitha të drejtat duke filluar nga e drejta e votës e deri tek ajo e qarkullimit. UDB-a pareshur bastiste shtëpinë e kësaj familjeje, kurse bashkëshatarët një periudhë të gjatë kohore e kishin të ndaluar nga regjimi të shkëlqin në truallin e Alushanëve. Nëse dikush nga anëtarët e familjes Alushani ka pasur nevojë të shkojë diku, këtë ka mundur të bëjë vetëm me leje speciale.

Rënia në burg e Muharremit për familjen Alushani ishte një goditje e madhe. Ymeri ishte fëmija i dytë që u lind, më 23 shtator 1964. Kujt do t'i shkonte ndër mend aso kohe, që pikërisht ky djalos 36 vjet më vonë do të hakmerrej ndaj pushtuesit për vuajtjet e popullit dhe të familjes së tij dhe me shembullin personal do të bëhej simbol i qëndresës.

Ymeri pas mbarimit të tetëvjeçares do t'i ndjekë mësimet e mesme në Gjymnazin "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" në Drenas, në të njëjtën periudhë aktivisht merret me muzikë në ish-ShKA "Zëri i Rinisë" të Bushatit. Frymëzimet e tij ai më pastaj do t'i derdhë në këngë. Pothuaj nuk kalonte natë, që Ymeri të mos këndonte këngën me përmbajtje patriotike "Oj Shqipni mos thuaj mbarova".

Ymeri ishte i apasionuar pas armëve. Që nga shkolla e mesme ai revolen nuk do ta hiqte nga brezi, ngaqë ishte i bindur se një ditë do të vinte koha kur edhe ai bashkë me moshatarë do t'i kundërviheshin me armë



pushtuesit në vijën e parë të zjarrit.

Ymeri kontaktonte me komandantin legjendar Adem Jashari

Kur ndodhi shthurja e ish-Jugosllavisë dhe nisën lëvizjet e para të rezistencës në Drenicë, menjëherë pas viteve të '90-ta, Ymer Alushani do të kontaktojë edhe me komandantin legjendar Adem Jashari për çështjen e grumbullimit të armëve. Se Ymeri ishte në përpjekjet e para të rezistencës ekzistojnë dëshmi dhe dëshmitarë të cilët pohojnë se Ymeri luftën dhe rezistencën e armatosur e shihte si njërën nga rrugët që Kosovën do ta nxirrte përfundimisht nga pushtimi serb. Në përpjekjet e para të viteve të '90-ta të gjitha grupet ilegale të interesuara që nëpërmjet rezistencës së armatosur të çloronin

Kosovën, tek Ymeri kishin mbështetur besimin dhe ndihmën e tij njëkohësisht. Bazuar në traditën e tij familjare, këto grupe nëpërmjet Ymerit mendonin të armatosnin popullatën në mënyrë që më pastaj t'i kundërviheshin pushtuesit. Mirëpo, kur pushtuesi i ra në gjurmë kësaj veprimtarie të "Vogëlushit", do ta bëjë rrethimin e shtëpisë dhe arrestimin e tij më 1992. Edhe pse do të kalojë nëpër një varg torturash, Ymeri do t'u bëjë ballë të gjithave dhe për asnjë çast nuk të tregojë për shokët. Kjo qëndresë e tij ndikoi që të mos ç'thurëj zinxhiri i lidhjeve me të cilët bashkëpunonte Ymeri.

Rezistenca e parë në Prekaz, më 30 dhjetor 1991, ishte sinjal i qartë se Drenica do të ngrëhte krye kundër pushtuesit. Komandanti legjendar Adem Jashari me këtë rezistencë u bë frymëzim edhe për Ymerin dhe shokët e tij. Armët

që i posedonte atë periudhë Ymeri llogariteshin për armatimin e një togu ushtarësh.

Fundi i vitit 1997 dhe dalja publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishin ndër shenjat më serioze që paralajmëronin se përlëshjet e drejtpërdrejta me pushtuesin do të shpeshtoheshin. Luftimet në Qafëmalin ndërmjet Rrezallës së Re dhe Rakinicës dhe qëndresa mbinjerëzore e Jasharëve më 28 janar, e veçanërisht më 5, 6, 7 dhe 8 mars të vitit 1998, lëkundën zemrat e mbarë shqiptarëve anekënd trojeve etnike dhe në mërgim.

Në mesin e të rinjve që nuk po pajtoheshin me dhunën dhe terrorin që po ushtronte regjimi gjakatar i Millosheviçit, ishte edhe Ymer Alushani që gjatë luftës do ta marrë nofkën "Vogëlushi". Ai kishte kohë që i përcillte nga afër ngjarjet, që zhvilloheshin në Drenicë dhe anekënd Kosovës. Shpeshherë nga shtëpia dilte natën dhe nuk kthehej deri në orët e hershme të mëngjesit. Dhe për këtë askujt nuk i thoshte asnjë fjalë.

Rënia heroike e Jasharëve i kishte kaluar kufijtë e durimit të tij. Krismat e mëngjesit të 9 majit të vitit 1998, Ymerin e gjejnë në Grykën e Llapushnikut, krah për krah me luftëtarët e lirisë në pozicionet e Grykës dhe prej atyre çasteve nga supet nuk do ta heqë automatikun dhe uniformën ushtarake.

Në betejën e 10 dhe 11 majit 1998, Ymeri do të tregohet mjaft aktiv në luftimet që ndodhen në Grykë dhe për humbjet që iu shkaktuan pushtuesit. Ishte ndër më të merituarit për suksesin që shënoi Ushtria Çlirimtare e Kosovës për ndërprerjen e aksit rrugor Prishtinë - Pejë për tre muaj me radhë.

Plagosja në betejën e Rahovecit

Pa vonuar vijat e frontit po zgjeroheshin. Në Rahovec forcat e pushtuesit kishin shtuar dhunën. Atje, si gjithkund, kur e kërkonte nevoja, u gjend edhe "Vogëlushi". Në përlëshjet e drejtpërdrejta me forcat e armikut merr plagët e para të lirisë.

Në secilin aksion "Vogëlushi" do të jetë ndër të parët. Ndërsa kur ndihej nevoja për armatim, ai në krye të kolonës disa herë do t'i përballojë bjeshkët e Pashtrikut për të hyrë në Shqipëri, në bazat e UÇK-së, për t'u furnizuar me armë.

Për tre muaj me radhë, në Grykën e Llapushnikut, "Vogëlushi" do të bëhet një ndër bedenat e pakapërcyeshëm që nuk do të lejonte për asnjë çast të kalonte çizme e ushtarit dhe policit serb nëpër Grykë. U krijua përshtypja se ai ishte i lindur për beteja. Me

gatishmërinë e tij do të marrë pjesë në betejat që ndodhen në Grykë të Carralevës, në Fushticë, Luzhnicë e gjetiu.

Lufta po përhapej anekënd Kosovës. Radhët e UÇK-së po shtoheshin dita-ditës. Pushtuesi pas vrasjeve të civilëve në fshatin Paklek i Ri kishte bërë planet për ta sulmuar Grykën e Llapushnikut, që mbahej mbyllur për tre muaj me radhë. Pushtuesi kishte organizuar sulmin nga drejtimi i udhëkryqit të Komoranit, duke futur në funksion bazat ushtarake në Golesh, Çukë, në stacionin e radios afër udhëkryqit të Komoranit, bazën policore ushtarake në fabrikën e "Ferronikelit" dhe një arsenal të madh të artillerisë, tankeve dhe këmbësorisë dhe një vijë sulmi prej tri kilometrash.

Pas një dyluftimi te vendi Palanat e Fushticës, ku u ndeshën ballë për ballë pjesëtarët e UÇK-së dhe forcat ushtarake serbe, më 25 korrik, të nesërmen, pushtuesi me forca të shumëfishuara, në orët e hershme të mëngjesit mësyu Grykën e Llapushnikut në përpjekje për ta hapur rrugën. Ai kishte përgatitur edhe një vijë fronti nga ana e Malishevës dhe e Kijevës.

Ymeri qëndronte në pozicione sepse më parë kishte dhënë betimin se për të gjallë nuk do t'i lëshonte forcat serbe të kalonin nëpër Grykë. Armiku kësaj here ishte përgatitur shumë, ngaqë ishte i bindur se me luftëtarët e lirisë siç ishte Ymer Alushani nuk do ta kishte të lehtë. Kështu në orët e hershme të mëngjesit të 25 korrikut kishte nisur drejt Grykës me arsenal të madh të mjeteve të blinduara, ushtarë e policë të panumërt, kurse në sulme, pos tankeve, kishte përdorur edhe sistemin raketor.


Sulmi dhe rezistenca në Grykë zgjatën mbi 33 orë. Nuk kishte lloje të armëve, që nuk përdori armiku mbi pozicionet e ushtarëve të UÇK-së, madje edhe armë kimike. Në mëngjesin e 26 korrikut, kur armiku kishte nisur tanket drejt pozicioneve të UÇK-së, Ymeri disa herë kishte shkrepur mbi mjetet e blinduara. Veprimi i tij iu ngjante luftëtarëve të lirisë, si Mic Sokoli e Hamëz Jashari. Ashtu si këta viganë të lirisë, me gjoksin e tij do ta ndalë marshimin e mëtejshëm të tankeve serbe nga ai drejtim ku rezistonte.

Lajmi për rënien e "Vogëlushit" u përhap anekënd atdheut. Pikëllimi ishte i papërshkruar si në radhët e familjes, bashkëluftëtarëve ashtu edhe të mbarë shqiptarëve, sepse ai tashmë ishte bërë simbol qëndrese. Kosova e humbi njërin prej luftëtarëve më të devotshëm për çështjen e atdheut.

Trupi i "Vogëlushit" prehet në Varrezat e Dëshmorëve në fshatin Kleçkë.

Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (7)

Veprimi i fushës antimagnetike të tokës në drejtim të Hënës



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Tani i kthehem edhe një herë eksperimentit numër katër. Kur sferën e hekurit e vendosim në vrimën eksperimentale ajo polarizohet dhe shndërrohet në një magnet i cili ka një fushë magnetike ((b)) ? (shih figurën 35 a). Në këtë rast fusha magnetike e sferës së magnetizuar ((b)) ? ka drejtim dhe kah të njëjtë me fushën magnetike ((B)) ? të magnetëve (N S) (shih figurën 33 b).

Vendosja e pllakave të hekurit mbi poet magnetike të njërit magnet cilindrik (N1 S1) do ta shkaktojë lindjen e fushës antimagnetike (-B) të vet atij magneti, e që në figurën 34 a. është e vijëzuar me ngjyrë të kuqe. Kjo fushë antimagnetike (-B) që buron nga ana anësore e magnetit (N1 S1) i largon të gjitha vijat e fushave magnetike (B) që ndodhen afër sipërfaqes së atij magneti në drejtim të periferisë.

Kahja e vijave të fushës antimagnetike (-B) është e kundër me fushën magnetike (B) të të gjithë magnetëve dhe është më e dendur afër sipërfaqes së magnetit (N1 S1) mbi të cilin janë vendosur pllakat e hekurit (vija me ngjyrë të kuqe) kurse më larg saj, intensiteti i fushave magnetike të përgjithshme është më i lartë (vija me ngjyrë të zezë), shih figurën 34 b.

Që do të thotë se momentet magnetike të sferës përkatësisht fusha magnetike e sferës (b) ose duhet të orientohen në drejtim të fushave magnetike (B) ose të fushës antimagnetike (-B).

Këto dy lloje të fushave konsiderohen si dy forca që kanë intensitet të ndryshëm, drejtim të njëjtë dhe kah të kundërt.

Kahja e fushave magnetike (B) dhe fushave antimagnetike (-B) për shkak të kahut të kundërt konsiderohen si forca shtytëse, prandaj në këtë rast dhe në këto rrethana, sfera metalike e kërkon atë gjendje të qetësisë, në të cilën është në gjendje t'i mbajë stabile momentet magnetike, përkatësisht fushën magnetike të sferës (b) të orientuar vetëm në drejtim të fushës magnetike (B), që konsiderohet si burim kryesor i magnetizimit të sferës së hekurit (Fe).

Veprimi i njëkohësishëm i këtyre dy forcave shtytëse (F) dhe (-B) në sferën e hekurit (Fe) e cila gjendet në gjendje të lirë dhe të pafiksuar mbi magnetin (N1 S1) mbi të cilin janë vendosur pllakat të hekurit (AB), do ta detyrojë sferën e magnetizuar të largohet nga vendi ku intensiteti i fushës anti-magnetike është më i lartë, dhe të kalojë më larg në një hapësirë ku intensiteti i fushave magnetike (B) është më i lartë.

Argument

Bazuar në këtë eksperiment, tërësisht ngjashëm, i njëjti proces është zhvilluar edhe ndërmjet tokës që ka një fushë magnetike dhe Hënës që nuk posedon fushë magnetike. Prandaj edhe një herë e rikujtojmë se miliarda vite më parë gjatë reaksionit të atomeve të




Fig 33a




Fig 33b

muar sfera ferromagnetike me rreze të ndryshme.

Nga ana e tjetër, prezenca e atomeve të elementeve (aX) te cikloni i Tokës ishte shumë herë më e madhe se te Hëna. Kjo ka ndikuar në të njëjtën kohë që cikloni i tokës ta tërheqë edhe Hënën edhe tornadon elektromagnetike pasi të dyja posedonin të njëjtat atome (aX).

Në atë kohë, distanca e tokës dhe Hënës mund të ishte sa gjysma e distancës së tanishme, por për fat të mospër-

darë edhe në hapësirën kur ishte krijuar Hëna.

Por kjo fushë magnetike nuk ishte e vetmja në hapësirën ku gjendej Hëna, aty ishin prezentë shumë fusha magnetike të trupave tjerë qiellorë duke e përfshirë edhe Diellin, që janë krijuar para tokës dhe Hënës.

Nga ana e tjetër, fushat magnetike, qoftë të diellit, tokës (B) apo trupave të tjerë qiellorë në një formë sado të padukshme, e kanë magnetizuar sferën ferromagnetike të Hënës.

Në këtë mënyrë, bërthama e Hënës, e përbërë nga materiali i hekurit (Fe), posedonte një fushë magnetike (b) shumë të dobët në brendësinë e saj.

Sado i vogël dhe i padukshëm nga toka që të jetë ky magnetizim prapë se prapë fusha magnetike e Hënës (b) përkatësisht momentet magnetike të hekurit në brendësi të Hënës janë orientuar në drejtim të fushës magnetike të tokës (B) si trup më i afërt që posedon një fushë magnetike (shih figurën 35).

Në momentin kur fusha magnetike me ndihmën e tornados elektromagnetike e kanë tërhequr hekurin likid nga të gjitha anët, duke e vendosur mbi poet magnetike të Tokës, ka lindur fusha antimagnetike ((-B) ?), e cila fushë tenton t'i orientojë momentet magnetike përkatësisht poet magnetike të Hënës në drejtim të kësaj fushe. Kahja e fushës magnetike ((b)) ?e Hënës dhe fushës antimagnetike ((-B) ?) që buron nga toka për shkak të kahut të kundërt, konsiderohen si forca shtytëse, prandaj në këtë rast dhe në këto rrethana sfera e magnetizuar e Hënës e kërkon atë gjendje të qetësisë në të cilën është në gjendje t'i mbajë stabile momentet magnetike,

përkatësisht fushën magnetike të Hënës ((b)) ? të orientuar vetëm në drejtim dhe kah të fushës magnetike të tokës ((B)) ? , që konsiderohet si burim kryesor i magnetizimit të sferës së hekurit (Fe) në brendësi të Hënës.

Veprimi i njëkohësishëm i këtyre dy forcave shtytëse (F) dhe ((-B) ?) në sferën e magnetizuar të Hënës e cila gjendet në gjendje të lirë dhe të pafiksuar në orbitën e saj rreth Tokës e ndalon afrimin e mëtejshëm të Hënës dhe do ta detyrojë të largohet në një distancë (d) në drejtim të periferisë, në një gjendje të qetësisë ku sfera e magnetizuar e Hënës, e ruan kahun dhe drejtimin fushës magnetike ((b)) ? të njëjtë me kahun e fushës magnetike të tokës ((B)) ? dhe fushave magnetike të trupave të tjerë qiellorë.

Në këto rrethana Hëna ndodhet përballë dy forcave: Forcës tërheqëse të ciklonit tokësor (forcës gravitacionale) që tenton ta ofrojë Hënën sa më afër tokës apo ta përplasë për tokën. Forcës shtytëse të fushës antimagnetike ((-B) ?) që buron nga anët anësore të dipolit magnetik të tokës që tenton ta largojë Hënën sa më larg tokës. Në këto rrethana, forca tërheqëse e ciklonit tokësor barazohet me forcën shtytëse të fushës antimagnetike ((-B) ?) dhe Hëna mbetet në një distancë nga toka, dhe rrotullohet rreth tokës në një orbitë ku gjithmonë kanë vlera të njëjta forcat shtytëse dhe tërheqëse. Prandaj kjo fushë antimagnetike që buron nga toka nuk është asgjë tjetër pos një fushë antigravitacionale që i kundërvihet fushës gravitacionale. **Vijon.**




Figura 35

elementeve (aX) dhe (aY) janë formuar ciklonet e tokës dhe Hënës në distanca qindra mijëra kilometra, kurse gjatë reaksionit të atomeve të elementeve (aX) dhe (aZ) janë formuar tornado elektromagnetike.

Masa e atomeve te cikloni i tokës ishte shumë më e madhe sesa te Hëna dhe kjo i ka dhënë mundësi ciklonit të tokës ta tërheqë më shpejt dhe më afër tornadon elektromagnetike, e krijuar nga reaksioni (aX) dhe (aZ).

Në këtë mënyrë janë krijuar dy trupa qiellorë, toka dhe Hëna nga të njëjtat reaksione të atomeve të elementeve (aX) dhe (aY), kurse tornadoja elektromagnetike nga reaksioni (aX) dhe (aZ).

Sikur toka ashtu edhe Hëna nën veprimin e forcës së cikloneve kanë tërheqë së pari elementet e rënda ferromagnetike rreth bërthamave të tyre, por toka ishte në epërsi në raport me Hënën për shkak të masës më të madhe të atomeve të elementeve (aX) dhe (aY).

Kështu që rreth tokës dhe Hënës njëkohësisht janë for-

plasjes së Hënës me tokën ishte tornadoja elektromagnetike e cila është tërheqë në brendësi të sferës ferromagnetike nga cikloni i tokës për shkak të atomeve të njëjta (aX).

Prezenca e Tornados elektromagnetike brenda sferës ferromagnetike e ka përzier hekurin dhe nikelin, apo përmes të ndonjë fërkimi që bën cilindri i tornados elektromagnetike e ka formuar rrymën elektrike, nga e cila është formuar fusha magnetike e tokës (B) apo dipoli magnetik në formë cilindrike ashtu siç ishte forma e Tornados.

Kjo fushë magnetike (B) që ka buruar nga toka është shpërn-




Fig 34a




Fig 34b

May rrit pagat e zyrtarëve përpara largimit

LONDËR, 22 KORRIK - Qeveria britanike njoftoi të hënën një masë për rritjen e pagave të një milion zyrtarëve, gjesti i fundit në favor të tyre nga ana e Theresa May dhe ministrit të saj të Financave, pak para largimit. "Mësuesit, ushtarët, mjekët dhe policët do të kenë një

rritje page këtë vit më të shpejtë se inflacioni, i cili aktualisht po rritet me ritmin e 2 % në vit", njoftoi Thesari britanik në një komunikatë. Rritjet do të ndryshojnë sipas profesioneve. Një mësues mesatarisht do të

ketë një rritje prej 2,75 % ose 1 000 sterlina në vit, një drejtues i ushtrisë do të fitojë 2,65 % më shumë ose 995 sterlina shtesë në vit. Policët do të fitojnë 2,5% deri në 978 sterlina më shumë në nivel vjetor dhe mjekët 1 500 sterlina më shumë mesatarisht në vit.



Presidenti Trump sulmon sërish katër ligjvënëset demokrate

Pas polemikave që kanë shpërthyer, presidenti Donald Trump përsëriti sulmet ndaj katër ligjvënësve demokrate me ngjyrë duke pohuar se ato nuk janë të afta për t'i dashur Shtetet e Bashkuara



UASHINGTON, 22 KORRIK - Presidenti Donald Trump përsëriti sulmet ndaj katër ligjvënësve demokrate me ngjyrë duke pohuar se ato nuk janë "të afta për t'i dashur Shtetet e Bashkuara". Deklaratat vijnë pas disa ditësh me komente të ngjashme nga ana e presidentit, të cilat kritikët i kanë konsideruar "raciste".

Javën e kaluar, gjatë një mitingu zgjedhor në Karolinën e Veriut, përkrahësit e presidentit Trump shpërthyen në thirrje që u shndërruan në subjekt polemikash. Thirrja "kthejini mbrapsht" vazhdoi për 13 sekonda përpara se presidenti ta riniste fjalimin.

Në Uashington, ku ngjarja u dënua në masë, presidenti u përpoq ta distancojë veten nga thirrjet. "Ishin thirrje të fuqishme, u ndjeva paksa keq, por mund të them se nisa të flas shumë shpejt, por thirrja nisi të bëhej më e shpejtë", tha presidenti Donald Trump. Në një postim në "Twitter" presidenti Trump vuri në dyshim aftësinë e katër ligjvënësve për t'i dashur Shtetet e Bashkuara.

Në emisionin "Këtë javë" të rrjetit televiziv ABC, ligjvënësi Elijah Cummings tha se retorika e për-

dorur së fundmi nga Trumpi është përçarëse për kombin. Ai tha se nuk ka dyshim se presidenti është racist. "President, ne duam që ju të jeni shembull. Duam dikë në Shtëpinë e Bardhë me të cilin fëmijët tanë të krenohen, ku të shohin veten e tyre, për të cilin të kenë respekt të madh dhe ky nuk është shembulli që ju po jepni", tha ligjvënësi demokrat Elijah Cummings.

Por një këshilltare e lartë e fushatës së Trumpit për të fituar një mandat të dytë presidencial, i doli në mbrojtje, duke hedhur poshtë pretendimet për racizëm. "Kam punuar me presidentin Trump për dy vjet dhe ai nuk është racist. Ai është një njeri i dhembshëm, politikati e të cilit janë përqendruar te pakicat. Ai është një president i orientuar drejt rezultateve, i cili është i përqendruar te lartësimi i të gjithë amerikanëve, përfshirë komunitetin afro-amerikan apo atë hispanik", thotë Mercedes Schlapp, këshilltare e lartë e fushatës Trump 2020.

Polemikat shpërthyen të dielën e kaluar kur Trump u tha katër ligjvënësve të "kthehen" në vendet nga të cilat kanë ardhur dhe "t'i rregullojnë gjërat" atje

përpara se t'i tregojnë ShBA-së se çfarë duhej të bëjë. Tri nga ligjvënëset kanë lindur në Shtetet e Bashkuara dhe që të katërtat janë shtetase amerikane.

"Komentet e Shtëpisë së Bardhë janë të turpshme e të neveritshme dhe komentet e tij janë raciste", tha kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi.

Të martën Dhoma e Përfaqësuesve votoi për t'i dënuar komentet e presidentit. Vetëm katër republikanë votuan ndryshe nga linja partiake.

Partia e presidentit Zelenskiy kryeson zgjedhjet parlamentare në Ukrainë

KIEV, 22 KORRIK - "Shërbëtori i Popullit", partia e presidentit të Ukrainës Volodimir Zelenskiy, duket se ka fituar shumicën në zgjedhjet parlamentare kur janë numëruar rreth 44 për qind të votave sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Partia e komedianit që u bë president ishte në krye në rreth 125 nga 199 zona zgjedhore në Ukrainë, deri në orën 9:15 të mëngjesit sipas orës lokale.

Partia e Volodimir Zelenskiy ka fituar shumicën në listat partiake duke marrë, sipas rezultateve partiake, 42 për qind ose 122 vende në parlament,

Nëse rezultatet nuk do të ndryshojnë kjo do ta shënonte herën e parë në historinë e pas pavarësisë së vendit, që një parti fiton shumicën në parlament.

Ukraina ka një sistem të përzier zgjedhor (proporcional e mazhoritar) sipas të cilit gjysma e vendeve të parlamentit përcaktohen nga listat e partive, ndërsa pjesa tjetër nga votimi direkt në zonat zgjedhore, ku kandidati që merr shumicën, fiton.

Rezultatet e fundit të lëshuara nga Komisioni Zgjedhor tregojnë se partia opozitare pro-ruse ishte në vendin e dytë me 43 vende.

Rezultatet e fundit të publikuara

nga Komisioni Zgjedhor tregojnë se kundërshtari kryesor i partisë "Shërbëtori i Popullit" është platforma e opozitës pro-ruse partia e quajtur "Për jetën", që renditet e dyta me 43 vende. Zelenskiy u tha mbështetësve të partisë së tij në selinë qendrore të fushatës zgjedhore se një nga prioritetet kryesore do të jetë "mposhtja e korrupsionit që vazhdon ta mbajë ta ngërthyer Ukrainën".

Pjesëmarrja në zgjedhje ishte rreth 50 për qind në zgjedhjet parlamentare të 21 korrikut të cilat u mbajtën tre muaj përpara afatit, sipas organizatës që vëzhgon procesin zgjedhor Opora.





“Parajsa me emrin Ksamil”, Portali amerikan shkruan për turizmin shqiptar

Portali i njohur amerikan, “Nothing Familiar”, që u kushtohet udhëtimeve dhe destinacioneve turistike më tërheqëse në botë, i ka kushtuar një reportazh plazheve të Ksamilit dhe ujërave të tyre të mrekullueshme.

“Vetëm në jug të Sarandës do të gjeni plazhin e Ksamilit dhe njëkohësisht një destinacion që duhet vizituar gjatë muajve të verës në Shqipëri. Vendasit dhe turistët udhëtojnë nga të gjitha anët për të shijuar diellin dhe për të notuar në detin e kristaltë të Jonit. Si njohës të vetëshpallur të plazheve na u desh ta shihnim këtë vend me sytë tanë! Ne kishim dëgjuar që Shqipëria kishte plazhe të mahnitshme, prandaj pse të mos e nisim me ato më të njohurat? Në vend që të shkonim në një udhëtim njëditor nga Saranda si shumë të tjerë, kaluam dy netë në Ksamil dhe shijuam çdo moment.

Bashkohuni me ne, teksa ndahemi rrugës për në plazhet dhe ishujt e Ksamilit, pse jo për të pasur informacion para se të shkoni dhe për të mësuar gjithçka që e bën këtë vend aq unik!”, shkruan ky portal.

“Ajo që e bën Ksamilin ndryshe nga çdo qytet bregdetar në Shqipëri është se nuk është vetëm një plazh i gjatë me rërë. Ai numëron dhjetëra gjire të vegjël që mbështillen rreth peizazhit të dhëmbëzuar. Çdo gjë menaxhohet nga një restorant apo bar që ka në pronësi shumë shezlonge në plazh dhe varka me pedale. Shihnim të mahnitur se si plazhistët hidheshin drejt e nga limani në ujën e ftohtë.



Rëra në plazhin e Ksamilit është e butë dhe e bardhë, ndërsa uji i detit i pastër kristal! Ky është një ndryshim për mirë nga pjesa tjetër e Rivierës Shqiptare, pasi pjesa më e madhe e plazheve të tjerë përgjatë bregut janë disi shkëmborë. Nëse shikoni larg drejt gjirit do të dalloni tre ishuj të mëdhenj shumë pranë bregut. Dy prej ishujve të Ksamilit janë aq pranë saqë mund të shkosh

me not deri atje. Megjithatë, shumica e njerëzve marrin me qira një kajak, ose një ndër shumë prej varkave, të lyera si të ishin makina garash. Më vonë zbuluam se ishujt e Ksamilit ishin të ndaluar për njerëzit gjatë epokës komuniste të Shqipërisë, me përjashtim të udhëtimeve private për gjueti të rezervuara për zyrtarë të lartë. Sot duket se ishujt po shfrytëzohen shumë

më mirë se atëherë”, thekson ai. “A jeni gati për një dozë dëshire të shfrenuar që do t’iu bënte të hiqnit dorë nga gjithçka vetëm e vetëm që të shkoni në Ksamil? Këto fotografi janë vetëm një ndjesi e mrekullisë së gjireve mahnitëse që formojnë këta plazhe tërheqës!

Në javën e parë të qershorit, qyteza ende bëhej gati për sezonin turistik të verës.



Ndërtesat po lyheshin, hotelet e rinj po mobiloheshin, ndërsa doket e portit po përforcoheshin. Para se ta vizitonim pyesnim veten përse në faqen booking.com mungonin të dhëna dhe komente për shumicën e gjithë këtyre hoteleve. Por tani e kuptuam. Arsyeja është se ato janë hotele tërësisht të rinj! Ndonëse frynte pak erë, ende nuk e besonim se i kishim për vete të gjithë plazhet e Ksamilit. U ulëm ndanë bregut me nga një gotë verë në dorë e ndërkohë sodisnim përfundimin e diellit pas ishujve të vegjël, ndërsa u ndjemë krejt vetëm dhe në parajsë.

Tani, siç edhe ju e dini, pjesa më e madhe e vendasve thonë se koha më e përshtatshme për ta vizituar këtë plazh është para, ose menjëherë pas sezonit turistik të verës. Kjo parajsë plazhi me siguri shndërrohet në një “stuhi”, ku njerëzit zihen për të zënë një rrip të vogël rëre. Në kushtet kur çdo vit këtu mbërrin një gjithnjë e më shumë vizitorë, provoni të vini në muajt korrik e gusht në Ksamil, nëse është e mundur.

Dy netët tona të mrekullueshme në Ksamil na dhuruan të gjithë plazhin që donim, ndërkohë që patëm edhe kohë të mjaftueshme për të vizituar edhe parkun kombëtar të Butrintit. Pak rëndësi ka nëse do të bësh një vizitë njëditore, apo pushime më të gjata në Ksamil, e sigurt është se do të çlodhni e djersiteni nën rrezet e diellit!”, përfundon “Nothing Familiar”.



E rrallë

Zbulohet xhamia në shkretëtirë, një nga më të lashtat në botë

Arkeologët kanë zbuluar në shkretëtirën e Negev në Izrael një xhami që mendohet se është më e lashta në botë. Xhamia, e cila daton në shekullin e shtatë apo tetë, u zbulua nga studiuesit e Autoriteteve të Antikave të Izraelit. Zbulimi u bë ndërsa gjatë punimeve për ndërtimin e një lagje të re në qytetin e Rahat. Arkeologët thanë se xhamitë e mëdha



të kësaj periudhe janë gjetur në Mekë dhe Jerusalem, por ishte e rrallë të gjendej një ndërtesë e tillë në këtë zonë.

FOTO E DITES



Njerëzit ecin në urën për këmbësorët gjatë vizitës në akullnajën më të madhe të Francës. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gjenden 50 balena pilotë të ngordhura, disa të mbuluara me rërë

Më shumë se 50 balena pilotë janë gjetur të ngordhura në një plazh të largët në Islandën Perëndimore. Ishin disa turistë të cilët ishin duke udhëtuar me helikopter, të cilët identifikuan në bregun e detit balenat e ngordhura. David Schwarzhans, piloti i helikopterit të Reykjavik, ka



theksuar se ai dhe pasagjerët e tij numëruan rreth 50 balena pilotë në bregun e detit në Gadishullin Snaefellsnes. Balena pilot është e njohur për grumbullimin në numër masiv.

BARSOLETA E DITËS



Trimi: Pse je kaq i qetë?
Arbeni: Sepse ua bëj rrafsh të gjithëve.
Trimi: Hiç s'po të besoj.
Arbeni: Mirë e ke.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
“X-Men; Dark Phoenix”

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,
Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

“M A”

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

<p>DASHI Sot gjatë gjithë ditës do të mendoni vetëm për çështje pune dhe financiare. Duhet të mendoni edhe për çështjet e zemrës.</p>	<p>DEMI Keni rezultate shumë të mira në një projekt që vijnë si pasojë e bashkëpunimit të shkëlqyer që keni me kolegët tuaj.</p>	<p>BINJAKËT Kujtime të ëmbla po ju lezetojnë ditën sot. Jeni të përkundur nga një ndjenjë kënaqësie që nuk e kuptoni dot se nga vjen.</p>	<p>GAFORRJA Sot dëshironi të qëndroni i qetë në ambientin tuaj që ju pëlqen aq shumë. Një ditë jo me ngjarje të veçantë për t'u mbajtur mend.</p>	<p>LUANI Duhet të mbani nën fre krenarinë tuaj dhe ambicien e tepruar sepse në të shkuarën keni bërë gabime që ju kanë kushtuar shtrenjtë.</p>	<p>VIRGJËRËSHA I keni pasur çastet tuaja të lavdisë dhe për këtë ndiheni shumë krenar. Mbrëmja paraqitet e qetë.</p>
<p>PESHORJA Sot është një ditë e mirë për takime pune ose konkurse. Fati është në anën tuaj dhe çdo gjë do të përfundojë në favorin tuaj.</p>	<p>AKREPI Sot do të vendosni të kaloni një ditë me miqtë sepse ju duhet mendimi i tyre për një vendim të rëndësishëm që do të merrni.</p>	<p>SHIGJETARI Jeni disi të pakënaqur me disa situata që po ndodhin rreth jush. Do të kërkonit ta gjeni fajtorin, por nuk do të mundni dot.</p>	<p>BRICJAPI Do t'ju vlerësojnë për aftësitë tuaja në punë sot dhe meritat do të jenë si morale, ashtu edhe financiare.</p>	<p>UJORI Sot ngjyra juaj është blu, si deti, si qielli, si çdo gjë që ju çon larg banales dhe vulgaritetit. Do të ndiheni shumë të lira.</p>	<p>PESHQIT Po ju vijnë në mend shumë çaste që keni dëshirë t'i riktheni. Kujtime të bukura që thjesht po ju shoqërojnë gjatë ditës.</p>

Irina Shayk harron Bradley Cooperin, shfaqet e lumtur në krahët e drejtorit të "British Vogue"



Edhe pse ka vetëm një muaj që i ka dhënë fund martesës me bashkëshortin Bradley Cooper, Irina Shayk është fotografuar në krahë të tjetër mashkulli. Supermodeluesja është fotografuar mjaft e lumtur në krahët e drejtorit të "British Vogue". Shayk është parë teksa po shëtiste në


një park në Nju Jork me drejtorin e "British Vogue", Alec Maxwell. Ata u panë duke qeshur dhe u përqafuar me njëri-tjetrin. Edhe në fotot e mëposhtme, 33-vjeçarja dhe Alec duken më shumë sesa miq. Duket se një romancë e re ka nisur në botën e shoubizit.

Arrestohet aktorja Sonja Sohn



Sonja Sohn është nën arrest. Aktorja 55-vjeçare u arrestua për posedim të kokainës, raporton "TMZ". Sonja

u arrestua në Karolinën Veriore për posedim të kokainës, posedim të marijuanës dhe për vegla të drogës.



Dua Lipa nuk ndahet nga i dashuri i ri

Prej disa javësh kryefjala e mediave është bërë romanca e re e këngëtares me origjinë shqiptare, Dua Lipës, me vëllanë e motrave Hadid, Anwarin. Pas ndarjes nga Isaac Carew, Dua u pa në shoqërinë e 20-vjeçarit dhe gjatë një festivali çifti u fotografua në çaste intime. Gjithashtu,

Anwar ishte i pranishëm në njërin prej koncerteve të Duas së bashku me motrën e tij, modeluesen Gigi Hadid, teksa e ndiqnin nga publiku performancën e saj, shkruan "iconstyle". Tashmë e gjithë familja e Anwarit e ndjek Dua Lipën në "Instagram" dhe çifti duket më i pandashëm se kurrë.

Lady Gaga dhe Bradley Cooper tanimë jetojnë bashkë?




Prej kohësh ylli i muzikës Lady Gaga dhe regjisori Bradley Cooper janë në qendër të vëmendjes së të gjithë mediave rozë, pasi dyshohet se janë në një lidhje dashurie. Dyshimet rreth kësaj lidhje u shtuan edhe më shumë pas

performancës së këngëtares dhe regjisorit në Oscar, ku përcollën emocione të mëdha përmes këngës "Shallow". Të dy yjet e Hollivudit hodhën poshtë çdo aludim, duke thënë se mes tyre nuk kishte asgjë më shumë se një miqësi e mirë.



Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Pensionohet rekordmeni Fitim Haliti

Rekordmeni i futbollit të Kosovës, Fitim Haliti, që ka shënuar 42 gola brenda një kampionati, ka vendosur të pensionohet nga loja e futbollit. Një gjë të tillë 37-vjeçari po e bën pasi arriti synimin e madh për ta ndihmuar skuadrën e Dukagjinit të inkuadrohet në Superligë. "Ashtu siç kam paralajmëruar edhe do të ndodhë, pra do të pensionohem. Sikurse gjithë futbollistët në botë, edhe unë kisha ëndërr që klubin e zemrës ta ndihmoj për t'u inkuadruar në rangun më të lartë të futbollit. Pasi kjo u arrit kam vendosur t'i them lamtumirë lojës së futbollit", ka thënë Haliti



kushtuar kësaj loje. Fillimisht do të ushtroj me fëmijët e rinj në skuadrën e Dukagjinit, më pas do t'i ndjek kurset për trajner. Përvojën time si futbollist do të përpiqem ta bart te gjeneratat e reja, pasi e ardhmja e futbollit është pikërisht te këto gjenerata", ka thënë Haliti.

Haxhi Zeka, lojtari më i mirë në Kosovë

Fitim Haliti ka pasur një karrierë të pasur futbollistike dhe ka luajtur me shumë futbollistë, por e ka veçuar Haxhi Zekën si më të mirin në futbollin e pasluftës. "Ka shumë lojtarë të mirë që kanë luajtur në Kosovë që prej përfundimit të luftës por, për mendimin tim, është Haxhi Zeka më i miri. Mëkat që ai dhe shumë të tjera nuk e kanë pasur mundësinë që të luajnë në Evropë, sepse cilësitë i kanë pasur. Zeka është më meritori për rekordin që e kam arritur në futbollin e Kosovës, sepse shumicën e golave i kam shënuar pas asistimeve të tij", ka deklaruar ai.

E ardhmja në futboll

Futbollisti legjendar i Dukagjinit, Fitim Haliti, edhe pse ka vendosur të pensionohet nga loja e futbollit, është i vendosur të mos i ndahet kësaj loje, kurse në të ardhmen e shihet veten si trajner. "Nga sporti, konkretisht futbollit, nuk do të ik asnjëherë, sepse gjithë jetën ia kam

bollit", ka thënë Haliti, i cili krenohet me sukseset që ka shijuar gjatë kohës si futbollist. "Karriera ime ka qenë shumë interesante. Kam luajtur në shumë klube dhe sukseset kanë qenë të jashtëzakonshme, për të mos thënë të paarritshme. Kam fituar tri herë titullin e kampionit me Besën e Pejës, dy herë Superkupën, derisa me Feronikelin dhe Dukagjinin jemi inkuadruar nga Liga e Parë në Superligë. Në aspektin personal kam rekordin që brenda një kampionati kam shënuar 42 gola, të cilën askush nuk e ka arritur në Kosovë", ka deklaruar ai. Haliti, i cili në opinion njihet me nofkën "Aqareva", karrierën futbollistike e nisi në moshën 16-vjeçare në skuadrën e Dukagjinit në të cilën edhe e mbylli karrierën, ndërsa ka luajtur edhe për Shqiponjën e Pejës,

Drenicën, Feronikelin, Besën e Pejës, Prishtinën dhe Besën e Kavajës. "Falënderoj trajnerët që kam punuar, bashkëlojtarët, klubet ku kam luajtur dhe të gjithë tifozët, në veçanti 'Hithat' e Dukagjinit", ka shtuar ai. Haliti ka bërë me dije se drejtori i klubit, Fabian Veselaj dhe kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, do t'ia organizojnë një ndeshje lamtumirëse.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 KORRIK - Rekordmeni i futbollit të Kosovës, Fitim Haliti, i ka qëndruar pas deklaratës që kishte dhënë në muajin janar për "Epokën e re", se do ta ndihmojë skuadrën e Dukagjinit të Klinës të inkuadrohet në Superligë e më pas të pensionohet. Haliti, i cili ka djersitur shumë fanella të klubeve në Kosovë, ka konfirmuar të hënën se karriera e tij si futbollist ka përfunduar. "Ashtu siç kam paralajmëruar edhe do të ndodhë, pra do të pensionohem. Sikurse të gjithë futbollistët në botë, edhe unë kisha ëndërr që klubin e zemrës ta ndihmoj për t'u inkuadruar në rangun më të lartë të futbollit. Pasi kjo u arrit kam vendosur t'i them lamtumirë lojës së fut-

Zbulohen kundërshtarët e mundshëm të Kosovës



PRISHTINË, 22 KORRIK - Në Munchen të Gjermanisë është hedhur shorti për kualifikimet e "Eurobasket 2021". Në këtë short 32 kombëtare janë ndarë në tetë grupe me nga katër skuadra, duke përfshirë këtu edhe organizatorët, Republikën Çeke, Gjeorgjinë, Gjermaninë dhe Italinë. Tri përfaqësueset e para në grupe do të kualifikohen tutje,

